



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Ministarstvo Infrastrukture i Transport,
Ministry of Infrastructure and Transportation

Prishtinë 24.04.2019

Në bazë të neneve 10, 11 të Ligjit nr. 06/L-133 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr 7/01 mars 2019), si dhe në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 17 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloret nr.14/2017, Nr.15/2017, Nr.16/2017, Nr.07/2018, Nr. 22/2018, Nr. 26/2018 dhe Nr. 30/2018, nenit 25 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjit Nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2019, lidhet ky:

ANEKS - MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM NË MES MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE KOMUNËS SË GJAKOVËS

Neni 1
Palët Nënshkruese

1. **Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit** e përfaqësuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, (në tekstin e mëtejme MIT),
dhe
1. **Komuna e Gjakovës**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 2

Aneksi është pjesë përbërëse e marrëveshjes për bashkëfinancim nr. KM/MI 127/18 të datës 01.02.2018 të lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe Komunës së Gjakovës.

Neni 3
Qëllimi

Qëllimi i Aneks Marrëveshjes është rirregullimi i vlerave financiare dhe emrit për projektin e më poshtëm

1. **Asfaltimi i rrugës Pac - Qafe Gjonaj - Babaj I Bokës (Faza 1 - Rruga e Peshkut)**, kodi i projektit nr.14719 në vlerë prej **477,110 €** (*Katërqind e shtatëdhjet e shtat mijë e njëqind e dhjetë euro*).

Neni 4

Pika 1.2 e Nenit 1 të Marrëveshjes plotësohet dhe ndryshohet si vijon:

- Ministria e Infrastrukturës do të financoj projektin në shumën e tërësishme të kontratës në shumë prej **477,110 €** (*Katërqind e shtatëdhjet e shtat mijë e njëqind e dhjetë euro*). Për vitin 2019 buxheti sipas ligjit 06/L-133 është ndarë 80,000 Euro ndersa pjesa tjetër do të mbulohet në vitet ne vijim.

Neni 5

Pjesa tjetër e tekstit të Memorandunit të Mirëkuptimit në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Gjakovës mbetet e pa ndryshuar.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Aneks i Memorandunit të Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Numri i Kopjeve

Ky Aneks i Memorandunit të Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje identike dhe atë nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Ministri i

Pal Lekaj



Kryetari i Komunës

Ardian Gjini

